



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1277

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AGRI BAU SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI(LOTO I)-Ritender me numër të prokurimit 616-25-9661-2-1-1, me 20/02/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE AGRI BAU SH.P.K. me nr. 2025/1277, e datës 26/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI(LOTO I)-Ritender me numër të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.
2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI(LOTO I)-Ritender me numër të prokurimit 616-25-9661-2-1-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik AGRI BAU SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.10.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI(LOTO I)-Ritender me numër të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Me 12.12.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë Te Fatosi Sh.P.K.

Me 16.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.12.2025, OE AGRI BAU SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1277, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AGRI BAU SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Lidhur me konstatimin e AK-së në pikën nr. 1 (Pretendimi 1)

Për ta pasur të qartë Autoriteti Kontraktues dhe secili institucion i lartpërmendur, fillimisht sqarojmë se kriteri për pikën 1 në Dosjen e Tenderit ishte përcaktuar si më poshtë:

2. OE duhet të jetë i licencuar me standardin ISO 9001:2015 për materiale dekorative.

Dëshmi: Kopje e certifikatës valide sipas kërkesës së AK-së.

Me rastin e ofertimit, ne kemi dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 për materiale dekorative, e cila ishte plotësisht valide në momentin e dorëzimit të ofertës. Ky fakt është konstatuar edhe nga vetë Autoriteti Kontraktues, i cili, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, fillimisht na ka shpallur fitues.

Prova:

B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK-së, datë 26.11.2025

Certifikata ISO 9001:2015 e dorëzuar me ofertë (shih më poshtë certifikatën, e cila ishte valide në momentin e ofertimit)

Është e rëndësishme të theksohet se, në momentin e ofertimit, certifikata ISO 9001:2015 ishte me afat valid, ndërsa gjatë kohës së vlerësimit ka kaluar afati i saj i vlefshmërisë. Kjo është një situatë normale, pasi certifikatat ISO kanë afat të caktuar validiteti.

Kompania jonë rregullisht pajiset me standardin ISO 9001:2015 për materiale dekorative, pasi ky standard na nevojitet për veprimtarinë tonë të përditshme, si dhe për bashkëpunim me institucione publike dhe subjekte private. Me kalimin e afatit të certifikatës së dorëzuar në ofertë, ne jemi pajisur sërish me një certifikatë të re ISO 9001:2015 për materiale dekorative, nga një kompani tjetër certifikuese, por me të njëjtin standard të kërkuar, duke dëshmuar se: kriteri është plotësuar në momentin e ofertimit; kriteri vazhdon të përmbushet edhe aktualisht.

Prova:

Certifikata ISO 9001:2015 paraprake;

Certifikata e re ISO 9001:2015 (nga kompani tjetër certifikuese, por me të njëjtin standard të kërkuar).

Megjithatë, AK-ja nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo dokument shtesë, ndonëse për këtë ishte e obliguar ligjërisht, në bazë të:

Nenit 59 të LPP-së;

Nenit 72 të LPP-së;

Nenit 4 të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP).

Kërkesa për sqarime në këtë rast nuk është diskrecion, por detyrim ligjor, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se AGRIBAU SHPK ishte ofertuesi me çmimin më të ulët.

Në vend që të kërkonte sqarime për një certifikatë që ka skaduar gjatë fazës së vlerësimit, AK-ja ka zgjedhur eliminimin tonë, edhe pse: kemi qenë të certifikuar në momentin e ofertimit; dhe jemi sërish të certifikuar edhe pas kalimit të afatit. Kjo nënkupton se e kemi plotësuar dhe vazhdojmë ta plotësojmë këtë kriter të paraparë në NJK dhe DT.

Verifikim selektiv i certifikatave ISO. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë selektive dhe të pabarabartë në procesin e verifikimit të certifikatave ISO, pasi që: Në këtë rast, AK-ja do të duhej të konstatojë se OE “Te Fatosi SHPK” ka paraqitur kontrata të papërgjegjshme, ose të konstatojë se ky OE është dashur të paraqesë si nënkontraktor kompaninë SEMI CLEANING SHPK, me të cilën kishte kontratë bashkëpunimi me titull “Marrëveshje Bashkëpunimi” me numër specifik projekti, ashtu siç e parasheh edhe Neni 30 – Nënkontraktimi, dhe si rrjedhojë ta eliminojë ofertën e tij si të papërgjegjshme.

Edhe përkundër këtyre mangësive serioze, Autoriteti Kontraktues ka favorizuar OE-në e shpallur fituese, pasi që lidhur me këtë marrëveshje nuk ka bërë asnjë krahasim substancial ndërmjet marrëveshjeve të OE-së fituese dhe marrëveshjeve tona për shfrytëzimin e pajisjeve, duke mos aplikuar të njëjtin standard vlerësimi.

Ky veprim përbën trajtim selektiv dhe diskriminues, në kundërshtim me:

Nenin 7 të LPP-së (trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi);

Nenit 1 dhe 6 të LPP-së;

praktikën e konsoliduar të OSHP-së.

Pajisjet – Shportat ngritëse

Për më tepër, theksojmë se vetëm me dy shportat tona ngritëse, për të cilat kemi dorëzuar dëshmi të pronësisë, kemi përmbushur plotësisht kriterin e kërkuar. Megjithatë, duke qenë se kemi pasur edhe dy pajisje të tjera të siguruara me marrëveshje për shfrytëzim me qira, kemi dorëzuar dëshmi edhe për këto dy pajisje shtesë, duke paraqitur dokumentacion për gjithsej katër (4) pajisje, edhe pse kriteri kërkonte vetëm dy (2).

Për rrjedhojë, eliminiimi ynë nuk ka asnjë bazë ligjore apo faktike dhe përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik.

Standard i dyfishtë i verifikimit

Për OE AGRIBAU SHPK, AK-ja ka kryer verifikim aktiv të certifikatës ISO 9001:2015 dhe ka konstatuar se gjatë fazës së vlerësimit i ka kaluar afati i vlefshmërisë, duke e përdorur këtë fakt si arsytim për eliminim.

Ndërsa për OE-në tjetër, të shpallur fituese, nga qasja në dokumente zyrtare rezulton qartë se AK-ja: nuk ka kryer asnjë verifikim të certifikatës ISO; nuk ka kërkuar konfirmim nga organi certifikues; nuk ka siguruar asnjë dëshmi zyrtare për vlefshmërinë e saj. Ky veprim dëshmon se AK-ja: ka aplikuar standard të dyfishtë vlerësimi; ka përdorur verifikimin vetëm për një OE (AGRIBAU SHPK); ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

AK-ja ka pasur informacion se OE “Te Fatosi SHPK”, i shpallur fitues, në tenderin e njëjtë në vitin paraprak nuk ka dorëzuar certifikatë valide ISO 9001:2015 për materiale dekorative, ose ekzistojnë dyshime serioze se e njëjta ka qenë e falsifikuar. Përkundër kësaj, AK-ja e ka shpallur fituese këtë OE, edhe pse oferta e saj ka qenë dukshëm më e lartë se oferta jonë.

Këto fakte janë konfirmuar edhe nga konstatimet e Ekspertit të OSHP-së në ekspertizën e tij, të cilat janë të potencuara edhe në vendimin e OSHP-së OSHP:2025_0732.

Pretendimi nr. 2 – Pajisjet teknike

Në vijim paraqesim sqarimet lidhur me kriterin tjetër për të cilin jemi eliminuar, edhe pse kemi dëshmuar në mënyrë të plotë se i përmbushim kriteret e parapara.

Kriteri, ashtu siç ishte përcaktuar në NJK dhe DT, ishte si më poshtë:

3. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimente dhe pajisje teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit: Dy shporta ngritëse për montim të ndriçimit dhe dekorimeve.

Dëshmi: Deklarata doganore, librezë e qarkullimit ose marrëveshje për shfrytëzimin e tyre.

Ne kemi dorëzuar dokumentacion dhe dëshmi për katër (4) pajisje, edhe pse kriteri kërkonte vetëm dy (2) pajisje:

për dy (2) pajisje kemi dorëzuar dëshmi të pronësisë;

për dy (2) pajisje të tjera kemi dorëzuar marrëveshje qiraje të vlefshme dhe funksionale (marrëveshje për shfrytëzim me qira për 3 vite).

Megjithatë, në letrën standarde të AK-së është konstatuar se ekzistojnë marrëveshje, por se në to nuk figuron emri dhe numri i aktivitetit të prokurimit.

Sqarojmë se askund në NJK dhe DT nuk është kërkuar që marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve të jenë të lidhura ekskluzivisht me këtë aktivitet të prokurimit, me emër dhe numër të prokurimit.

Vendosja e një kërkesë të tillë pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave përbën ndryshim të kriterëve dhe është në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3 të LPP-së, i cili përcakton se tenderuesi nuk mund të diskualifikohet në baza të kërkesave që nuk janë të cekura në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Pretendimi ynë nr. 3 – Lidhur me konstatimin e AK-së në pikën nr. 3

Në pikën e tretë të eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se posedon materiale/mostra sipas parametrave të kërkuar gjatë vizitës në terren (shih konstatimin e AK-së).

Sipas konstatimit të AK-së:

3. GOE – Aneksi 1:

GOE nuk ka arritur të dëshmojë se posedon materiale ose mostra sipas parametrave të kërkuar. Komisioni i vlerësimit, gjatë vizitës në terren, ka konstatuar se konsorciumi nuk ka arritur të paraqesë materiale ose mostra dhe për këtë arsye është konsideruar jo i përgjegjshëm.

Ky konstatim i komisionit është i pabazuar, i manipuluar dhe në kundërshtim të plotë me Dokumentacionin e Tenderit.

Fillimisht sqarojmë se, me Dosjen e Tenderit, nuk është kërkuar dorëzimi i mostrave gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, por qartë është përcaktuar se mostrat/rezervat lidhen me fazën pas nënshkrimit të kontratës, ashtu siç parashihet në Kushtet e Veçanta të Kontratës, konkretisht:

Rezervat – Kualiteti i Kontrollit (Neni 17.1):

10 ditë pas nënshkrimit të kontratës, OE duhet të ketë rezerva për të gjitha produktet e kontratës në stoke; Implementimi i kontratës do të caktohet në planin e menaxhimit;

OE i nevojitet 1 muaj për montimin e dekoreve;

Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit, në përputhje me Nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme dhe adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës.

Nga dokumentacioni kontraktual rezulton qartë se rezervat dhe mostrat lidhen ekskluzivisht me fazën e implementimit të kontratës dhe jo me fazën e vlerësimit të ofertës.

Autoriteti Kontraktues, në pikën nr. 3 të eliminimit, ka konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë posedimin e materialeve/mostrave gjatë vizitës në terren. Ky konstatim është i pavërtetë, i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Dosjen e Tenderit, si dhe me faktet e dokumentuara me shkrim ndërmjet palëve.

Me email zyrtar të datës 18.11.2025, Autoriteti Kontraktues, përkatësisht zyrtari i prokurimit z. Kreshnik Ismajli, ka njoftuar se komisioni i vlerësimit do të dalë në terren për verifikimin e përmbushjes së aspektit vizual 90%, bazuar në deklaratën e dorëzuar nga OE.

Ne kemi paralajmëruar zyrtarin e prokurimit z. Kreshnik Ismajli, ZPP z. Visar Shehu dhe dy anëtarët e tjerë të komisionit përmes emailit, duke ua tërhequr vërejtjen se: Kjo vizitë nuk është konform deklaratës sonë dhe nuk përputhet me kërkesat e parashikuara në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike;

Kërkesa e përshkruar në Aneksin 1 lidhet me realizimin e dekorimit në terren pas nënshkrimit të kontratës, e jo me verifikimin e stokut apo inspektimin fizik të produkteve në depo. Edhe pse ne kemi kundërshtuar mënyrën e realizimit të vizitës, zyrtari i prokurimit ka insistuar që komisioni ta realizojë vizitën (komunikim i cili bashkëngjitet kësaj ankese).

Çfarë ka ndodhur realisht gjatë vizitës në terren. Komisioni ka vizituar ambientet e kompanive tona, ka parë veprimtarinë afariste, materiale dekorative dhe mostra të ngjashme, si dhe materiale bazë që montohen në terren. Është diskutuar përmbajtja e deklaratës së dorëzuar në ofertë, e cila lidhet me realizimin në terren dhe jo me posedimin e materialeve gjatë fazës së vlerësimit. Komisioni ka mbajtur procesverbal, i cili është nënshkruar nga ne pa asnjë vërejtje për mungesë materialesh apo mostrash. Pas vizitës së datës 18.11.2025, komisioni i vlerësimit ka rekomanduar kompaninë tonë për kontratë dhe Autoriteti Kontraktues ka publikuar dokumentin B58 – Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, me të cilin GOE Agribau SHPK & AneaGroup SHPK është shpërblyer me kontratë. Kjo dëshmon se komisioni ka qenë i bindur për kapacitetet tona për realizimin e kontratës.

Megjithatë, më vonë, në letrën standarde për eliminim, AK-ja ka shtrembëruar qëllimin e vizitës, duke pretenduar mungesë materialesh/mostrash – kriter i cili nuk ka ekzistuar fare.

Ky veprim bie drejtpërdrejt ndesh me nenin 56.3 të LPP-së, i cili ndalon diskualifikimin për kritere që nuk janë të cekura në NJK dhe Dosjen e Tenderit.

Eliminimi për “mungesë materialesh/mostrash dekorative” është faktikisht i rremë, i sajuar, juridikisht i paqëndrueshëm dhe proceduralisht i paligjshëm, veçanërisht duke pasur parasysh se në procesverbalin e vizitës nuk ekziston asnjë vërejtje për mungesë materialesh.

Pretendimi ynë nr. 4 – Lidhur me konstatimin e AK-së në pikën nr. 4

Në letrën standarde për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka dhënë një konstatim lidhur me çmimet e ofertuara nga Grupi i Operatorëve Ekonomik, duke pretenduar se çmimet janë të paarsyeshme dhe jo reale.

Sipas arsyetimit të AK-së:

4. GOE – Paramasa:

GOE ka paraqitur çmime që nuk përputhen me tregun, pasi në disa pozicione ka çmime shumë të ulëta dhe në disa pozicione çmime shumë të larta, të cilat janë sqaruar dhe interpretuar me vendimin e ZPP-së.

Për këtë arsye, AK ka konstatuar se oferta jonë është jo bindëse, e papërgjegjshme dhe rrezikon ekzekutimin e projektit.

Ky konstatim është jo profesional, i paargumentuar dhe plotësisht i pabazuar në fakte dhe në ligj. Autoriteti Kontraktues nuk ka specifikuar asnjë pozicion konkret me çmime të ulëta apo të larta, nuk ka bërë asnjë krahasim me çmimet e tregut dhe nuk ka paraqitur asnjë analizë financiare apo teknike.

Një konstatim i tillë pa analiza dhe prova përbën deklaram arbitrar dhe të qëllimshëm.

Sipas LPP-së dhe praktikës së konsoliduar të OSHP-së, para se një ofertë të shpallet e paarsyeshme në çmim, AK është e obliguar të kërkojë sqarime me shkrim nga OE, të analizojë strukturën e çmimeve dhe të dokumentojë procesin e analizës.

Në rastin konkret, asnjë kërkesë për sqarim nuk na është adresuar, çka përbën shkelje të rëndë procedurale.

AK i referohet “interpretimit nga ZPP”, pa sqaruar se kur është kërkuar ky interpretim, për cilën çështje konkrete dhe me cilin akt zyrtar. Ligji nuk parasheh që interpretimi i ZPP-së të zëvendësojë analizën e komisionit vlerësues.

Kjo ngre dyshime serioze mbi funksionimin real të komisionit të vlerësimit dhe integritetin e procedurës.

Në mungesë të çdo analize konkrete dhe mungesës së kërkesës për sqarim, ky konstatim nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminim dhe përbën abuzim procedural, veçanërisht duke pasur parasysh se ne jemi ofertuesi me çmimin më të ulët.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik “Agri Bau SHPK” (tutje “parashtruesi”), me datë 16.12.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto I) – Ritender”, me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit, është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (in meritum) të kërkesës.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde, përmes së cilës parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur se arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, paragrafi 63.1.1, nënparagrafi b), lidhur me nenin 62, paragrafi 62.1, nënparagrafi d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikat III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, paragrafi 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1277, ndërsa me datë 18.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1277, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AGRI BAU SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1277 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues, pas verifikimit të detajuar dhe individual të të gjitha dokumenteve të përfshira në dosjen e tenderit, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitura nga pala ankuese, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), aktet ligjore sekondare të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), si dhe në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit, me theks të veçantë në ecurinë e procedurës tenderuese ashtu siç është kontestuar në ankesë, konstaton si vijon:

Prete dimet e palës ankuese:

Përgjigje e ekspertit shqyrtues - lidhur me kronologjinë e aktivitetit të prokurimit dhe pretendimet e palës ankuese

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Pas përfundimit të fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar për dhënie kontrate ofertën e operatorit ekonomik Agri Bau Sh.p.k., vendim i cili është formalizuar përmes Vendimit B58 – Njoftim për Dhënie Kontrate.

Kundër këtij vendimi, operatori ekonomik pjesëmarrës te Fatosi Sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, duke ushtruar të drejtën e tij ligjore në përputhje me nenin 108/A të LPP-së – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, me të cilën ka atakuar vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie kontrate.

Bazuar në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur kundër vendimit B58 – Njoftim për Dhënie Kontrate, Autoriteti Kontraktues, me datë 03.12.2025, ka vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim. Në këtë kuadër, është angazhuar Komisioni për Rivlerësim të Ofertave, i cili, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, ka konstatuar se oferta e operatorit ekonomik fillimisht të rekomanduar për kontratë (Agri Bau Sh.p.k.) përmbante mangësi në disa dokumente të ofertës, për çka oferta është vlerësuar si e papërgjegjshme.

Si rrjedhojë e këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me raportin e Komisionit për Rivlerësim, Autoriteti Kontraktues, me datë 11.12.2025, ka rekomanduar për dhënie kontrate operatorin ekonomik te Fatosi Sh.p.k., duke reflektuar gjetjet e raportit të rivlerësimit të ofertave.

Pjes nga raporti i komisionit të ri-vlerësimit;

Më datën 16.12.2026, operatorët ekonomikë në grup, përmes të autorizuarit Agri-Bau Sh.p.k., në cilësinë e palës me interes në këtë aktivitet të prokurimit, kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës, me të cilin është rekomanduar për dhënie kontrate operatori ekonomik Fatosi Sh.p.k..

Në kërkesën e paraqitur, pala ankuese pretendon se Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe të argumentuar për vendimin e marrë, duke theksuar se, sipas vlerësimit të saj, pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim kanë qenë të bazuara dhe të argumentuara, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Pretendimi numër 1 i palës ankuese:

Mendimi dhe të gjeturat e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së palës ankuese rezulton se është paraqitur certifikata ISO 9001:2015, me afat vlefshmërie deri më 13.11.2025, ndërkohë që hapja e ofertave është realizuar më datën 12.11.2025. Rrjedhimisht, në momentin e hapjes së ofertave, certifikata në fjalë ka qenë valide dhe në fuqi.

Megjithatë, gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave, sipas verifikimeve të kryera nga eksperti shqyrtues dhe bazuar në dokumentacionin e procedurës tenderuese të publikuar në platformën e e-Prokurimit, është konstatuar se certifikata ISO 9001:2015 nuk ka qenë valide në atë fazë, për shkak të skadimit të afatit të saj të vlefshmërisë. Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktues,

respektivisht Komisioni për Rivlerësim të Ofertave, ka rekomanduar që oferta përkatëse të shpallet e papërgjegjshme.

Eksperti shqyrtues vlerëson se operatori ekonomik ankues, duke pasur parasysh se certifikata ISO 9001:2015 ka qenë pranë skadimit të afatit, gjatë fazës së ofertimit ka pasur mundësi dhe përgjegjësi të paraqesë dëshmi plotësuese, përfshirë deklaram apo dokumentacion që vërteton se është në procedurë të ri-certifikimit për standardin ISO 9001:2015. Nga shqyrtimi i dokumenteve të lëndës nuk rezulton se është paraqitur ndonjë dëshmi e tillë në fazën përkatëse të ofertimit.

Megjithatë, eksperti shqyrtues vëren se Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të rivlerësimit, ka pasur mundësi ligjore të kërkojë sqarime ose dokumentacion shtesë, duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, meqenëse certifikata ISO 9001:2015 bën pjesë në kategorinë e dokumenteve që mund të sqarohen apo përditësohen, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Në këtë drejtim, operatori ekonomik ankues, së bashku me ankesën, ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 të ri-vazhduar, me periudhë vlefshmërie nga 18.11.2025 deri më 17.11.2028, çka dëshmon vazhdimësinë e certifikimit për standardin përkatës. Për rrjedhojë, në këtë kontekst, pretendimi i palës ankuese vlerësohet si pjesërisht i bazuar.

Pretendimi numër 2 i palës ankuese:

Mendimi dhe të gjeturat e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor numër 3 – Kapaciteti teknik dhe profesional.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankues në platformën e e-Procurement, rezulton se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin për katër (4) makineri – kamionë me vinç dhe me korp, të cilat, bazuar në të dhënat e prezantuara, përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, lidhur me kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional.

Dokumentacioni i ngarkuar në platformë përmban të dhëna të mjaftueshme dhe të verifikueshme mbi ekzistencën dhe disponueshmërinë e makinerive të deklaruara, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktues vlerësimin e drejtë dhe objektiv të këtij kriteri, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ftesën për Dorëzimin e Tenderëve (FDT) dhe Dosjen e Tenderit.

Në këtë kontekst, konstatohet se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues, i cili lidhet me mënyrën e vlerësimit të kriterit të kapacitetit teknik dhe profesional nga Autoriteti Kontraktues, është i bazuar, pasi nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kriteri në fjalë është plotësuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi numër 3 i palës ankuese:

Mendimi dhe të gjeturat e ekspertit shqyrtues – Pretendimi nr. 3

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit, si dhe i shkresave zyrtare të shkëmbyera ndërmjet palëve, rezulton se Dosja e Tenderit nuk parasheh detyrimin për dorëzimin apo prezantimin e mostrave apo materialeve gjatë fazës së vlerësimit të ofertave. Përkundrazi, dokumentacioni i tenderit përcakton qartë se rezervat dhe mostrat lidhen me fazën e nënshkrimit dhe implementimit të kontratës, siç parashihet në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Konkretisht, operatori ekonomik obligohet të ketë rezerva në stok dhjetë (10) ditë pas nënshkrimit të kontratës, ndërsa testimi dhe inspektimi i materialeve realizohen në momentin e dorëzimit, në përputhje me nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Në këtë kontekst, konstatohet se Autoriteti Kontraktues, lidhur me pretendimin nr. 3 të eliminimit, e ka bazuar vendimin e tij në një kriter që nuk ka qenë i aplikueshëm në fazën e vlerësimit të ofertave, duke e konsideruar mungesën e mostrave gjatë vizitës në terren si element eliminues.

Po ashtu, nga procesverbali zyrtar i datës 18.11.2025 rezulton se Autoriteti Kontraktues ka sqaruar se vizita në terren kishte për qëllim verifikimin vizual të përmbushjes në masën rreth 90%, bazuar në deklaratimet e dorëzuara nga operatori ekonomik, çka konfirmon se kjo vizitë është realizuar gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, e jo në fazën e zbatimit të kontratës.

Për rrjedhojë, konstatohet se veprimi i Autoritetit Kontraktues në këtë pikë nuk janë në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe dokumentacionin parakontraktual, andaj pretendimi i palës ankuese vlerësohet si i bazuar.

Pretendimi numër 4 i palës ankuese:

Përgjigje e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor nr. 4 – Çmimi i ofertuar

Nga shqyrtimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues, si dhe i dokumentacionit të administruar në këtë lëndë, rezulton se konstatimi për eliminimin e operatorit ekonomik lidhur me çmimin e ofertuar është bazuar në vlerësimin se disa pozicione të listës së çmimeve janë të paarsyeshme.

Megjithatë, nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk rezulton se gjatë fazës përkatëse të procedurës është kryer analizë e strukturuar financiare apo teknike për secilin pozicion konkret të listës së çmimeve, e cila do të përfshinte elemente si: struktura e kostos, materialet, punët, transporti, montimi, si dhe arsyet e mundshme të devijimit nga çmimet e tregut apo faktorë të tjerë objektivë që mund të ndikojnë në realizimin e kontratës.

Po ashtu, nuk rezulton se operatorit ekonomik i është kërkuar sqarim në përputhje me nenin 61 të LPP-së – Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, lidhur me çmimet e ofertuara, procedurë kjo që do të mundësonte verifikimin e bazës reale dhe objektive të çmimeve të ofertuara, qofshin ato të ulëta apo të larta. Dokumentacioni i lëndës nuk evidenton ndjekjen e ndonjë procedure të mirëfilltë nga komisioni për analizë të detajuar të çmimeve apo krahasime të arsyetuara për pozicionet specifike të kontestuara.

Në këtë kuadër, konstatohet se vlerësimi i çmimit të ofertuar nuk është shoqëruar me arsyetim të mjaftueshëm dhe dokumentim të detajuar, duke mos mundësuar verifikim të plotë të bazës faktike mbi të cilën është mbështetur vendimi për eliminimin e operatorit ekonomik në këtë pikë.

Ky konstatim i ekspertit shqyrtues bazohet ekskluzivisht në mungesën e analizës së dokumentuar dhe të strukturuar të çmimeve në dosjen e lëndës dhe nuk ka për qëllim të vlerësojë politika apo praktika të Autoritetit Kontraktues, por të japë një vlerësim teknik dhe objektiv mbi procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin e administruar. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor i palës ankuese lidhur me këtë pikë vlerësohet si i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit DEKORIMET VERORE, DIMËRORE DHE SHËNIMI I DATAVE ME RËNDËSI(LOTO I)-Ritender me numër të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet B58Njoftimi mbi vendimin e AK-se dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: